



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Skyfterat live shpk” të datës 28.08.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik në objektet shëndetësore- Ri-tender” me nr. të prokurimit 616-25-10100-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Skyfterat live shpk” të datës 28.08.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik në objektet shëndetësore- Ri-tender” me nr. të prokurimit 616-25-10100-2-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Skyfterat live shpk” (tutje “parashtruesi”) me datë 28.08.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik në objektet shëndetësore- Ri-tender” me nr. të prokurimit 616-25-10100-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "Kundërshtimi i arsyeve të eliminimit Pika 1 - Marrëveshja për themelimin e GOE Në njoftimin tuaj thuhet se forma e marrëveshjes së GOE është ndryshuar në faqen e fundit dhe nuk është nënshkruar/vulosur nga përfaqësuesi. Theksojmë se ky element është inekzistent dhe nuk është kriter i vlerësimit i përcaktuar në dosjen e tenderit dhe nuk përbën mospërputhje thelbësore që ndikon në përmbajtjen ose validitetin e ofertës sonë. Marrëveshja jonë e dorëzuar është pikërisht formulari standard i miratuar nga KRPP dhe përmban të gjitha elementet e saja, ku lideri dhe anëtari i grupit kanë vulosur dhe nënshkruar në këtë dokument, pra arsyetimi juaj ska asnjë bazë ligjore. Formulari është i plotësuar si duhet dhe përmban të gjitha informatat mbi aktivitetin e prokurimit. Pika 2 - Marrëveshja me OE ELRON për marrjen me qira të veturave Pretendimi se marrëveshja nuk specifikon cilat vetura bëhet fjalë dhe nuk lidhet drejtpërdrejt me aktivitetin e prokurimit është i pabazuar, ngase dosja e tenderit nuk kërkon në mënyrë eksplicite detajizim të tillë dhe nuk kërkon asnjë detaj. Në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë nuk është kërkuar që në marrëveshje të specifikohet apo ti dedikohet aktivitetit të prokurimit, kërkesa është e qartë sipas dosjes së fundit të korrigjuar me datën 29.01.2025 ku thuhet: "Evidenca 5. Automjetet duhet të jenë të regjistruara në emër të kompanisë, ose dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre automjeteve me Qira, periudhën sa do të zgjasë kontrata dhe të kenë librezat e qarkullimit valide – Kopje;", për më tepër nëse ju keni pasur paqartësi keni mundur që të kërkonit informata sqaruese konform Nenit 72 të LPP-së. Marrëveshja në fjalë është e përgjithshme dhe mund të përdoret për cilindo aktivitet të prokurimit, dhe për cilat vetura bëhet fjalë OE ka vendosur librezat e veturave ku figurojnë të gjitha informatat e nevojshme. Pika 3 - Lista e kontratave (Aneksi 7)? Në pretendimin tuaj thuhet se nuk është dorëzuar Aneksi 7 sipas formës së përcaktuar. Sqarojmë se të gjitha format e kërkuara janë dorëzuar nga operatori ekonomik dhe janë përputhur me kërkesat thelbësore. Nëse janë konstatuar mospërputhje formale, këto nuk mund të çojnë në përjashtim, pasi dosja e tenderit nuk ka paraparë penalitet të tillë dhe as nuk mund të interpretohet në dëm të konkurrencës së lirë. Pika 4 - Deklarata për pagën minimale Eliminimi mbi bazën se nuk është cekur titulli dhe numri i prokurimit është joproporcional dhe jo në përputhje me ligjin, sepse ky element nuk përbën kusht thelbësor për vlerësimin e ofertës, por thjesht një aspekt administrativ i deklaratës. Ligjërisht, mosshënimi i numrit të prokurimit nuk mund të konsiderohet arsye për refuzim të ofertës. 3. Kundërshtimi i pikës 5 - Çështja e çmimit minimal Në lidhje me arsyetimin e dhënë për çmimin dhe mos-përputhjen e tij me formularët e tenderit dhe paramasën, sqarojmë se kjo çështje tashmë është res judicata (pjesë e gjykuar) sipas vendimit të OSHP nr.471-25, datë 06.08.2025, i cili ka vendosur përfundimisht mbi këtë kontest. 5. Mos-përgjegjshmëria e OE të rekomanduar për kontratë Edhe përkundër faktit se OE "Besa Security" si i rekomanduar për kontratë në këtë aktivitet të prokurimit dhe cilësohet si i përgjegjshëm, ne kemi argumente dhe fakte se bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë i njejtë nuk është i përgjegjshëm për këto arsye: 1. Në dosjen e tenderit është kërkuar: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 Kërkesa 4. Operatori ekonomik duhet të caktoj a)- minimum (1) menaxher të projektit me vendim i cili ka përvojë pune min.3 vite dhe është i certifikuar për menaxhim risku dhe i licencuar nga MPB si menaxher i sigurimit zyrtar në detyrë si për shërbimet themelore dhe të specializuara. Evidenca 4. a). Dëshmi që Menaxheri i Projektit duhet të ketë të kryer shkollimin e mesëm, të dëshmohet me kopje të diplomës, b. Duhet të dëshmoj se ka përvojë 5 vjeçare në lëmin e sigurimit fizik, c. Duhet të dëshmoj me Licencën për Menaxher nga MPB-me në fushën e sigurisë fizike sipas Ligjit Nr.04 L-004 për Shërbimet Private të sigurisë. - "Dokumentet e menaxherit me emër KRESHNIK IMERAJ" i njejtë është i licensuar

vetëm si Menaxher për shërbimet themelore të sigurisë, dhe jo për ato të specializuara siç parashihihen sipas Ligjit për Shërbimet Private të Sigurisë e të cilat janë Menaxher për Operatorët e Mbikqyrjes Elektronike, Menaxher për Rojet e Transportit të Parave të Gatshme apo Menaxher i Operatorëve të Mbrojtjes së Afërt e të cilat cilësohen bazë të Ligjit Shërbime të Specializuara. Sipas kërkesës së njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar të jetë i licensuar për dy shërbimet; 1.themelore, 2.specializuara. Personi në fjalë ka vendosur "Certifikatën nga MPB" për trajnime të specializuara mirëpo për pozitën Menaxher i Sigurimit për Shërbimet Themelore dhe ka tentuar që ta lajthit Autoritetin Kontraktues, mirëpo ju keni kërkuar që Menaxheri të jetë i licensuar dhe jo i certifikuar".

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Komisioni i rivlerësimit pas rishqyrtimit dhe krahasimit të ofertës ka konstatuar mbi te gjeturat se GOE SKYFTERAT – LIVE” SH.P.K. dhe “JAGUAR SECURITY” SH.P.K. nuk kanë dëshmuar me ofertën e tyre ti plotësojnë këto kërkesa sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit:

1. Marrëveshjen për themelimin e GOE është ndryshuar forma sepse në faqen e fundit është larguar pjesa ku duhet të nënshkruhet dhe vuloset përfaqësuesi i GOE (dmth është ndërhyrë në formularin e marrëveshjes për themelimin e GOE).
2. Marrëveshja me OE ELRON për marrjen me qeras për veturave nuk është në harmoni me kërkesën sepse nuk përmban dhe nuk specifikon se për cilat vetura behet fjale po ashtu kjo marrëveshje nuk i referohet aktivitetit të prokurimit me titull dhe numër të prokurimit.
3. Te lista e kontratave nuk është plotësuar aneksi 7 i DT por janë dorëzuar disa lista të kontratave që janë hartuar vet nga OE (edhe pse në DT specifikisht thuhet që duhet të plotësohet aneksi 7 dhe kjo është e obligueshme për 2 lotet). Përndryshe format që janë dorëzuar nga OE dhe format e aneksit 7 janë kërkuar të dhëna ma shume (numri, emaili etj) te cilat mungojnë në formularët e prezantuar nga OE.
4. Te deklarata për pagën minimale, nuk ceket titulli dhe numri i prokurimit.
5. Si dhe mos përputhjes të çmimit në formularin e tenderit 1,248,712.98 Euro dhe çmimit të paramase për muaj 83,120.28Euro .

Komisioni i rivlerësimit pas rishqyrtimit bazuar mbi te gjeturat e lartshënuara konstaton se kjo oferte është e pa përgjegjshme.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuar në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që komisioni për rivlerësim të gjitha të arsyet eliminuese i ka argumentuar në mënyrë të mjaftueshme ndërsa parashtruesi në pretendimet e tij


ankimore nuk ka prezantuar asnjë argument ligjor të matshëm dhe të ligjshëm. Në fakt për disa nga arsyet eliminuese parashtruesi parimisht nuk prezanton fare kundërshtimin e tij por vetëm aludon se ato nuk janë relevante për eliminimin e ofertës së parashtruesit si të papërgjegjshme.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesin e rekomanduar është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP. Pavarësisht kësaj është gjetur se oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 01.09.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.